

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit

Misioni Të synojë realizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve publike në komunitet. Kjo drejtori merr të gjitha masat e duhura si nga pikëpamja inxhinierike, ashtu dhe financiare për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të rrjetit të infrastrukturës publike mbitokësore dhe atë nëntokësore (kanalizime), mirëmbajtjen e fasadave, varrezave, sipërfaqeve të gjelbërta e rekreative, përcaktimin e zgjerimeve të nevojshme, si dhe realizimin e rrjeteve të reja të kanalizimeve etj.

Detyrat

1. Vlerëson si një nga aspektet më prioritare raportet dhe kërkesat ndaj sipërmarrjeve private, për realizimin cilësor të shërbimeve të kontraktuara si: pastrimi, gjelbërimi, shërbimi funeral dhe dekori.
2. Bashkërendon punën me faktorë të tjerë të interesuar në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike dhe përfshirjes së banorëve në monitorimin vlerësimin dhe bashkëqeverisjen komunitare, si: OJF-të, organizatat rinore (parlamentin rinor, qeveritë e shkollave), etj.
3. Vlerëson si detyrë permanente mirëmbajtjen e rrjetit rrugor, sistemin e kanalizimeve, sinjalistikën vertikale dhe horizontale, rrjetin e ndriçimit publik, dekorin, sipërfaqet e gjelbërta etj.
4. Ruan dhe mirëmban përmes sipërmarrjes private sipërfaqet e varrezave publike dhe ato të dëshmorëve dhe parashikon investime të vazhdueshme për përmirësimin e infrastrukturës së tyre dhe zgjerimin e sipërfaqeve të varrezave.
5. Ndjek me përgjegjësi zbatimin e urdhrave dhe vendimeve të Kryetarit të Bashkisë dhe ato të Këshillit Bashkiak për probleme që kanë lidhje me drejtorinë e Shërbimeve Publike.
6. Punonjësit e kësaj drejtorie janë gjithnjë në gadishmëri të plotë 24 orë në 24, pavarësisht se në ditë normale kohëzgjatja e punës së tyre është 8 (tetë) orë.
7. Gjithsesi, në çdo rast kur për arsye nga më të ndryshmet (kryesisht emergjence), punonjësve u kërkohet nga eprori angazhimi edhe pas orarit zyrtar të punës, ata duhet ta zbatojnë.
8. Mos-zbatimi i urdhërave të eprorit (në rastin konkret, drejtorit), qofshin këto edhe gojore (pra, jo domosdoshmërisht me shkrim), është shkak për marrje të masave disiplinore ndaj cilido punonjës, sipas Kodit të Punës dhe neneve të kësaj rregulloreje.